

Fatmir ARIFI

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: fatmir.arifi@live.com

ORCID: 0009-0004-2754-6035

KUD: 070(496.51)“1970/1981”(05)

&

Dorina DAIU

Instituti i Studimeve për Krimet

dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri

Email: dorina.daiu@iskk.gov.al

ORCID: 0009-0009-2724-3938

KUD: 070(496.51)“1970/1981”(05)

**SHTYPI I FSHEHTË - GAZETA, SI INSTRUMENT
KOMUNIKIMI DHE REZISTENCE NGA ORGANIZATAT
E FSHEHTA ME KARAKTER ÇLIRIMTAR NË KOSOVË
GJATË VITIT 1970-1981**

Abstrakt:

Ky studim synon të ofrojë një analizë të thelluar të tipologjisë së komunikimit të organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë gjatë periudhës 1970-1981, duke vendosur në epiqendër rolin që ka luajtur shtypi i fshehtë si formë alternative dhe e domosdoshme e komunikimit politik, ideologjik dhe kombëtar me masat e gjera popullore. Në një kohë kur aparati shtetëror jugosllav kontrollonte të gjitha kanalet zyrtare të informacionit dhe përdorte propagandën për të delegitimuar çdo përpjekje emancipuese shqiptare, jashtë doktrinës jugosllave të vëllazërim-bashkimit, shtypi i fshehtë u shfaq si mjete i vetëm për të artikuluar qëndrime, për të prodhuar diskurs kundër-hegemonik dhe për të krijuar hapësira të reja të ndërgjegjësimit politik. Studimi fokusohet veçanërisht në veprimtarinë e organizatës së fshehtë me karakter çlirimtar, “Grupi Revolucionar i Kosovës-GRK”, e cila më vonë mori emrin Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës - OMLK, një ndër subjektet më aktive në prodhimin, shpërndarjen dhe institucionalizimin e shtypit të fshehtë shqiptar gjatë viteve '70 dhe fillimit të viteve '80. Në qendër të analizës tonë studimore do të vendosim rolin dhe funksionimin e gazetave të fshehta

si “Zëri i Kosovës”, “Pararoja” dhe “Liria”, të cilat nën drejtimin e kësaj organizate u shndërruan në platforma informuese, edukuese dhe mobilizuese në hapësirën shqiptare jashtë Shqipërisë londineze. Përkundër rrezikut të përhershëm të penetrimit të shërbimit sekret jugosllav dhe të kushtëzuar nga ruajtja e konspiracionit të thellë, ky shtyp arriti të krijojë një sistem të qëndrueshëm komunikimi alternativ, ku ndërthureshin ideologjia, analiza politike dhe kërkesat për të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Ai shtyp përçoi një narrativë të qartë emancipimi, duke përhapur ide mbi të drejtën e vetëvendosjes, çlirimin politik dhe projektin e bashkimit kombëtar shqiptar. Në mungesë të një hapësire publike të lirë, shtypi i fshehtë funksionoi si një formë e krijimit të opinionit paralel, ku diskursi politik shqiptar merrte trajtë të artikuluar dhe të pavarur nga mekanizmat e kontrollit shtetëror. Studimi do të ndërtohet mbi disa shtylla kryesore analitike. Së pari, trajtohet konceptualizimi teorik i shtypit të fshehtë dhe ndikimi i tij në kontekste represive, duke e vendosur rastin e Kosovës në një panoramë më të gjerë të rezistencave politike në Evropën Juglindore. Së dyti, në kuadër të këtij shtypi do të analizohet zanafilla e shtypit të fshehtë shqiptar në Kosovë dhe viset e saj nën Jugosllavi, duke shqyrtuar kushte kontekstuale, ndikimin e mërgatës dhe rrjetet e shpërndarjes. Së treti, në kuadër të këtij studimi do të bëhet një analizë e thukët e përmbajtjes së gazetave të përmendura, me synimin për të zbërthyer gjuhën politike, strukturën argumentuese dhe temat qendrore të diskursit të tyre. Së fundi, do të shqyrtohet rëndësia socio-politike e këtij shtypi, ndikimi i tij në mobilizimin e rinisë, roli në procesin e politizimit të shoqërisë dhe kontributi në krijimin e një identiteti politik kolektiv në prag të demonstratave shqiptare të vitit 1981. Një tezë thelbësore e hulumtimit do të jetë krahasimi midis shtypit të fshehtë shqiptar dhe shtypit zyrtar jugosllav, duke evidentuar dy pole diskursive antagoniste: njëri i ndërtuar mbi kontroll, delegitimim dhe unifikim të realitetit sipas modelit shtetëror jugosllav, e tjetri i ngritur mbi rezistencën, kritikën dhe projektin e lirisë kombëtare. Ky kontrast i dy botëkuptimeve do të shërbejë për të kuptuar jo vetëm rolin historik të shtypit të fshehtë, por edhe mekanizmat e prodhimit të dijes politike në kushte të një fshehtësie të thellë të organizuar.

Fjalë kyçe: Komunikim politik, shtypi i fshehtë, GRK, rezistencë, Jugosllavi, vetëvendosje, bashkim kombëtar.

Abstract:

This study aims to provide an in-depth analysis of the communication typology of clandestine liberation-oriented organizations in Kosovo during the period 1970-1981, focusing on the role played by the underground press as an alternative and necessary form of political, ideological, and national communication with the broader popular masses. At a time when the Yugoslav state apparatus controlled all official channels of information and used propaganda to delegitimize any Albanian emancipatory efforts outside the Yugoslav doctrine of brotherhood and unity, the underground press emerged as the only means to articulate positions, produce counter-hegemonic discourse, and create new spaces for political awareness. The study focuses particularly on the activities of the clandestine liberation-oriented organization, the “Kosovo Revolutionary Group – KRG,” which later became known as the Marxist-Leninist Organization of Kosovo – OMLK, one of the most active entities in producing, distributing, and institutionalizing the Albanian underground press during the 1970s and early 1980s. At the center of our study is the role and function of the underground newspapers such as “Zëri i Kosovës”, “Pararoja”, and “Liria”, which, under the direction of this organization, became informative, educational, and mobilizing platforms within the Albanian space outside of -Albania. Despite the constant risk of infiltration by the Yugoslav secret service and constrained by the need to maintain deep secrecy, this press managed to establish a stable system of alternative communication, intertwining ideology, political analysis, and demands for the national rights of Albanians. It conveyed a clear narrative of emancipation, spreading ideas about the right to self-determination, political liberation, and the project of Albanian national unification. In the absence of a free public space, the underground press functioned as a form of parallel opinion-making, where Albanian political discourse took on an articulated and independent form, free from state control mechanisms. The study will be structured around several main analytical pillars. First, it addresses the theoretical conceptualization of the underground press and its impact in repressive contexts, situating the case of Kosovo within a broader panorama of political resistance in Southeastern Europe. Second, within this framework, the origins of the Albanian underground press in Kosovo and its territories under Yugoslavia will be analyzed, examining the contextual conditions, the influence of the diaspora, and the distribution networks. Third, the study will conduct a detailed content analysis of the aforementioned newspapers, aim-

ing to dissect their political language, argumentative structure, and central themes of their discourse. Finally, the socio-political significance of this press will be examined, including its impact on youth mobilization, its role in the politicization of society, and its contribution to the formation of a collective political identity on the eve of the Albanian demonstrations of 1981. A central thesis of the research will be the comparison between the Albanian underground press and the official Yugoslav press, highlighting two antagonistic discursive poles: one built on control, delegitimization, and the unification of reality according to the Yugoslav state model, and the other founded on resistance, critique, and the project of national liberation. This contrast between the two worldviews will serve to understand not only the historical role of the underground press but also the mechanisms of producing political knowledge under conditions of deep and organized secrecy.

Keywords: Political communication, underground press, KRG, resistance, Yugoslavia, self-determination, national unification.

Hyrje

Periudha ndërmjet viteve 1970-1981 përbën një nga fazat më të ndërlikuara dhe njëkohësisht më dinamike të historisë së rezistencës shqiptare në ish-Jugosllavi, pas viteve të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kohë, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën sundimin jugosllav, vepronin organizata të fshehta me karakter çlirimtar, të cilat, përballë censurës së hekurt politike dhe represionit shtetëror, zhvilluan një sistem të pavarur komunikimi politik me masat e gjera popullore. Ky sistem, i cili u materializua përmes shtypit të fshehtë, trakteve, broshurave të xhepit dhe rrjeteve të shpërndarjes nga celulat e tyre, u bë instrumenti kryesor i përhapjes së ideve kombëtare dhe revolucionare.

Këto organizata, si Grupi Revolucionar i Kosovës-GRK-OMLK, dhe të tjera me profil të ngjashëm, shfrytëzuan formate të ndryshme të komunikimit për të shtresuar një vetëdije të re politike dhe kombëtare, me qëllim për të ruajtur lidhjen e tyre me masat e gjera popullore shqiptare. Përmes gazetave “Zëri i Kosovës”, “Pararoja” dhe “Liria”, si dhe përmes broshurave të xhepit, ato trajtuan tema të ndaluara në shtypin zyrtar jugosllav, si p.sh. çështja e të drejtës për vetëvendosje për shqiptarët, e drejta historike për bashkim

kombëtar dhe padrejtësitë që vinin nga politikat shtetërore federative të Jugosllavisë ndaj popullsisë shqiptare. Në këtë kuadër, komunikimi i fshehtë nuk ishte vetëm një mjet informimi, por edhe një formë rezistence kulturore dhe politike, që i parapriu ngritjes së ndërgjegjes kombëtare në vitet pasuese. Shtypi i fshehtë krijoi një hapësirë alternative publike për veprimtarët e organizuar anti- Jugosllavisë, në të cilën u artikuluan idetë e lirisë, barazisë dhe identitetit kombëtar, përtej kufizimeve të sistemit komunist jugosllav.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë tipologjinë e komunikimit të këtyre organizatave, me theks të veçantë, duke shqyrtuar strukturën e shtypit të fshehtë, funksionin e tij edukativ e mobilizues, përmbajtjen ideologjike dhe ndikimin e tij në formimin e një vetëdije të re shoqërore e kombëtare. Përmes analizës së dokumenteve, botimeve dhe dëshmive të kohës, synojmë të vëmë në pah rolin e këtij tipi të komunikimit si pjesë e pandashme e procesit të luftës për liri dhe dinjitet kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi.

Kuadri i përgjithshëm

Shtypi i shkruar ka luajtur gjithmonë një rol të jashtëzakonshëm në çdo shoqëri, duke u shndërruar në një mjet kryesor për informim, edukim, promovim të kulturës dhe zhvillim shkencor. Në kuadrin e komunikimit të organizatave të fshehta me masat e gjera popullore, gazeta shërbente jo vetëm si një kanal për shpërndarjen e informacionit të saktë, por edhe si një instrument socio-politik dhe mobilizues. Për shoqërinë, në rrethana normale, gazetat do duhej të shërbenin si një burim i besueshëm informacioni, duke u dhënë lexuesve mundësinë për t'u informuar në mënyrë objektive dhe pa ndikim indoktrinues. Përveç funksionit të informimit, shtypi do duhej të krijonte një mjedis për debat dhe diskutime publike mbi çështjet e ndryshme të zhvillimit shoqëror, duke nxitur reflektimin kritik dhe ndërgjegjësues. Përveç kësaj, i komunikimit me masat e gjera, në këtë rast gazeta, do të duhej të ishte një mjedis i mirë për debatet dhe diskutimet publike mbi çështjet të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Gjithashtu, gazeta është një mjetë i rëndësishëm për të promovuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke bërë që shoqëria të ndihet më e përgjegjshme dhe më e ndërgjegjësuar për çështjet që kanë ndikim në të drejtat e tyre. Janë dhe disa arsye shtesë se përse shtypi i shkruar është i rëndësishëm.

Së pari, misioni i tij është të ofrojë informacion të besueshëm, duke u bërë një mjet i rëndësishëm për të ndjekur zhvillimin e ngjarjeve dhe për të marrë informacione të rëndësishme dhe të sakta.

Së dyti, shtypi i shkruar në krahasim me mediat vizive apo fonike, do të duhej të shquhej për analiza më të thella, duke ofruar raporte më të hollësishme në çështjet që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë.

Së treti, shtypi i shkruar do të duhej të shquhej edhe për nga thellësia e temës. Gazetat dhe revistat periodike shpeshherë shkruajnë për tema që nuk janë të përfshira në mediat e tjera, duke ofruar një perspektivë të ndryshme dhe më të hollësishme në çështjet që ndikojnë në shoqëri. Së katërti, shtypi i shkruar është një mjet i komunikimit të qëndrueshëm. Në krahasim me mediat e tjera, shtypi i shkruar mund të lexohet pa pasur nevojë për ndonjë pajisje elektronike dhe mund të ruhet për një kohë të gjatë. Së pesti, ai do të duhej të shquhej si mjet i lirisë së fjalës, nga e cila mund të ndikojnë për ndryshime pozitive në shoqëri. Andaj dhe në tërësinë e tij ishte dhe mbetet një mjet i rëndësishëm në evoluimin e mendimit në shoqëri, duke ofruar informacion të besueshëm, analiza të thella dhe perspektivë të ndryshme në çështjet që ndikojnë në jetën tonë.

Megjithatë, në kontekstin e Jugosllavisë, këto parime nuk u përmbajtën nga shtypit zyrtar. Shtypi jugosllav nuk ofronte informacione të pavarura dhe objektive, por funksiononte si një mekanizëm shtetëror për të justifikuar mohimin e të drejtave të shqiptarëve nën ideologjinë komuniste. Në vend që të denonconte padrejtësitë, ai i relativizonte dhe i promovonte në emër të propagandës shtetërore, duke e kthyer shtypin në një instrument kontrolli ideologjik dhe manipulativ.

Që nga pas Lufta e Dytë Botërore, të gjitha organet e informimit jugosllav, qofshin gazetatat, format vizive apo fonike, ishin nën kontroll të plotë të regjimit totalitar. Në këtë kontekst, shtypi kishte një rol të qartë propagandistik-destruktiv. Ai deformonte historinë dhe identitetin e shqiptarëve, duke i paraqitur në mënyrë të manipuluar për qëllime ideologjike të komunizmit jugosllav.

Nga njëra anë, shtypi jugosllav mohonte dhe manipulonte informacionin mbi ngjarjet dhe trashëgiminë historike të shqiptarëve; nga ana tjetër, promovonte konceptin e një identiteti hibrid, të quajtur “vëllazërim-bashkim”, që synonte të krijonte një ndjenjë uniteti artificial midis shqiptarëve të Kosovës dhe popullsisë sllave të rajonit. Ky identitet i imponuar nuk kishte lidhje reale me historinë, gjuhën, kulturën apo identitetin e shqiptarëve, duke e bërë

shtypin zyrtar një instrument të fuqishëm për kontroll ideologjik dhe shoqëror brenda federatës jugosllave.

Brenda kuadrit të federatës jugosllave shtypi ishte nën kontrollin e rreptë të regjimit komunist dhe nuk kishte asnjë liri apo pavarësi reale. Ai funksiononte si një mekanizëm i drejtpërdrejtë i aparatit shtetëror dhe partiak, duke u përdorur dhe keqpërdorur sipas nevojave të situatave të ndryshme. Ky kontroll shtrihej në të gjitha nivelet: federative, republikane dhe krahinore, ku çdo material i botuar duhet të reflektonte linjën ideologjike dhe politikën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, duke eliminuar çdo mundësi për kritikë apo debat të lirë. Në lidhje me këtë çështje, studiuesja R. Zeqiri shkruan: “Lidhja e Komunistëve zbatonte një strategji të gjithanshme propagandistike edhe në gjuhën shqipe. Përmes emisioneve televizive, radios, gazetave dhe revistave, të cilat ishin organe të strukturave partiake në nivelin e njësisë federative, komunistët jugosllavë paraqisnin Jugosllavinë si një “parajsë të realizimit të të drejtave kombëtare”¹. “...Sa i përket shtypit në gjuhën shqipe në Kosovë, disa nga gazetatat me shtrirje të gjerë ishin: gazeta “Rilindja”², revista “Zëri i Rinisë”³ dhe revista “Kosovarja”⁴, të cilat u shndërruan në instrumente të fuqishme të propagandës jugosllave. Ndërsa, për shqiptarët në Maqedoni, gazeta “Flaka e Vëllazërimit”⁵ bartte flamurin e kësaj propagande”⁶.

Përballë një dhune psikologjike të tillë nga propaganda e shtypit jugosllav, siç argumenton R. Zeqiri, “as fëmijët nuk kishin mbetur jashtë strategjisë politike të regjimit jugosllav. ...Revista “Fatosi” dhe “Pionieri” shërbenin si “organe teorike” për fëmijët e shkollës tetëvjeçare, duke përcjellë propagandën e edukimit në frymën e konceptit të “vëllazërim-bashkimit” të modelit jugosllav”⁷. Këto argumente bazohen në analizën e hollësishme që autorja ia bën shtypit jugosllav të kohës, i cili ishte i mbushur me shkrime antihistorike, antiidentitare dhe antikulturore, që preknin drejtpërdrejt sentimentin shqiptar. Për më tepër, një qasje e tillë me tentativë për shpëlarjen e trurit kundrejt fëmijëve shqiptarë u përdor edhe në librat shkollorë, me qëllim

¹ Rudina Zeqiri, “Format Specifike të Komunikimit të Organizatave të Fsheta shqiptare Gjatë Monizmit Jugosllav”, Tetovë 2000, f. 41.

² Organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Kosovës.

³ Organ i Rinisë Socialiste të Kosovës.

⁴ Organ i Gruas Socialiste të Kosovës.

⁵ Organ i Frontit Popullor të Republikës Socialiste të Maqedonisë.

⁶ Po aty, f. 41-42.

⁷ Po aty.

manipulimin e mendjes së fëmijëve shqiptarë, duke retushuar të gjithë njësitë mësimore të shkollave fillore dhe të mesme që kishin të bënin me historinë, letërsinë dhe kulturën e popullit shqiptar.⁸

Për sa u tha më sipër, një dëshmi e qartë ofrohet edhe nga dokumentet arkivore, veçanërisht nga analiza e shtypit të kohës, të cilat ruhen në Arkivin e Shtetit Shqiptar dhe kanë të bëjnë me Kosovën. Çdo numër i gazetave jugosllave dhe i mjeteve të tjera të informimit, përveç që stigmatizonte lëvizjet progresiste në Kosovë me viset e saj nën Jugosllavi, shfrytëzohej gjithashtu për të akuzuar dhe shtetin shqiptar në mënyrë të paskrupullt. Sipas këtij shtypi, Tirana zyrtare akuzohej se, gjoja, “vetëm verbëria nacionaliste e ka shtyrë udhëheqjen shqiptare të hyjë në rrugë aventure dhe shumë të rrezikshme. Këta njerëz mbajnë përgjegjësi të plotë për të gjitha pasojat e politikës së tyre irredentiste dhe nacionaliste shqiptaro madhe kundër Jugosllavisë”.⁹

Ky qëndrim i shtypit jugosllav shërbente si një mjet për të delegjitimuar çdo veprim progresist shqiptar, duke e paraqitur shtetin shqiptar si një kërcënim dhe përgjegjës për tensionet në rajon, ndërsa mohonte dhe deformonte realitetin historik dhe aspiratat kombëtare të shqiptarëve të Kosovës dhe territoreve të saj nën sundimin e Jugosllavisë. Megjithatë, pyetja jonë hulumtuese që do të parashtrohet është se kur dhe nga kush nisi të botohet gazeta si tip i komunikimit me masat e gjera popullore nga organizatat e fshehta me karakter çlirimtar?

Zanafilla e shtypit të fshehtë të tipit të gazetave, në mënyrë të organizuar dhe të strukturuar, nisi në vitin 1973. Ky lloj komunikimi me masat e gjera popullore u iniciua nga organizata “Grupi Revolucionar i Kosovës-GRK”, e cila vazhdoi aktivitetin e organizatave të mëhershme atdhetare. Në fund të viteve ’60 dhe fillim të viteve ’70, GRK arriti një shkallë më të lartë organizative, si nga dimensionimi pragmatik ashtu edhe nga pikëpamjet teorike dhe ideopolitike, duke vendosur bazat e një sistemi të qëndrueshëm agjitativ anti-jugosllav përmes shtypit të fshehtë e të shkruar. GRKja, si organizatë e fshehtë me karakter çlirimtar dhe anti jugosllav, mobilizoi strukturat e veta vepruese dhe elitat intelektuale brenda radhëve të saj të organizuar për realizimin e një veprimtarie shumëdimensionale, duke përfshirë edhe përgatitjen e shtypit të fshehtë. Ky mobilizim shquhej si faza më e avancuar e organizimit

⁸ Gazeta, Rilindja “Shprehje e fuqishme e Ideologjisë së LKJ-së”, editorial, gusht 1982.

⁹ Arkivi i Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme - AMEPJ i Shqipërisë, Drejtoria e IV, Dosja Nr. 1140, fl, 191, titulli i dosjes, “Kosova”, titulli i dokumentit, “Deklarata të udhëheqësve jugosllav për demonstratat shqiptare të vitit 1981, viti 1981.

të veprimtarisë anti-jugosllave, ku shtypi nuk konceptohej vetëm si një instrument informimi, por si një mjet strategjik agjitativ e mobilizues. Në këtë kontekst, gazetat e fshehta funksionuan si instrumente të fuqishme të luftës anti-jugosllave, duke ndërthurur edukimin socio-politik, mobilizimin e opinionit publik dhe forcimin e identitetit kombëtar shqiptar në kushtet e shtypjes dhe censurës sistematike. Ky rol i tyre tregon qartësisht se veprimtaria e shtypit të fshehtë nuk kishte vetëm një karakter propagandistik, por përbënte një element thelbësor të strategjisë organizative për avancimin e kauzës çlirimtare.

Në mbledhjen e parë konstituive, brenda kuadrit të vendimeve të Komitetit Drejtues të GRK-së¹⁰, ishte përcaktuar se, përveç përdorimit të parullave, broshurave të xhepit dhe komunikimit përmes incizimeve në kasete¹¹, politika shtetërore e Jugosllavisë duhej të sfidohej edhe përmes shtypit të shkruar të organizatës. Në kuadër të kësaj mbledhje u themelua gazeta “Zëri i Kosovës”, si organ agjitativ i organizatës GRK. Ky vendim pasqyroi ndërgjegjësimin strategjik të drejtuesve të saj për rëndësinë e shtypit si instrumenti më i avancuar i komunikimit me masat e gjera popullore, i cili mund të shërbente si mjet ideopolitik dhe mobilizues për zhvillimin e veprimtarisë çlirimtare në kushtet e censurës dhe kontrollit të rreptë shtetëror.

Përgatitja dhe shpërndarja e kësaj gazete, e cila mbante një karakter tërësisht përmbajtësor dhe dallonte qartë nga shtypi zyrtar jugosllav, përbënte një ndërmarrje jashtëzakonisht sfiduese dhe me një shkallë të lartë rreziku. Pa u ndikuar nga këto rreziqe dhe me një vendosmëri të lartë, pothuajse vetëflijuese, Grupi Revolucionar i Kosovës nisi veprimtarinë e tij në këtë drejtim, duke synuar të zhvillonte një propagandë anti-jugosllave të strukturuar dhe të koordinuar, e cila kishte për qëllim mobilizimin dhe ndërgjegjësimin e masave të gjera popullore për kauzën çlirimtare. Drejtuesit e organizatës arritën që numrin e parë periodik, të konceptuar si organ agjitativ i saj, ta nxirrnin në qarkullim në mënyrë të fshehtë më datë 1 shkurt të vitit 1974, me emrin “Zëri i Kosovës”.¹² Gazeta u përgatit dhe u botua në mënyrë thellësisht konspirative nga vetë drejtuesit e organizatës, duke respektuar rregullat strikte të sigurisë dhe konspiracionit, duke siguruar kështu që përmbajtja ideopolitike të transmetohej në mënyrë të kontrolluar dhe efektive te shtresat e synuara të

¹⁰ Kjo mbledhje është mbajtur në familjen Hajrizi, në mars të vitit 1973.

¹¹ Tipi i kasetave ishte zakonisht incizimi i fjalimeve të ndryshme të drejtuesve të Republikës së Shqipërisë, ose radiodrama dhe material të tjera.

¹² Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës- ASHAK, Ekzemplarë i gjetur: Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësia Organike: Penale, Nr. R. 74, Nr. L. 69, viti 1982.

shoqërisë. Në këtë rrafsh, pyetja e dytë hulumtuese është se si erdhi deri tek emërtimi i kësaj gazete me emrin “Zëri i Kosovës”?

Nga hulumtimet që kemi zhvilluar, vendimi për të emërtuar organin agjitativ të organizatës GRK-së me titullin “Zëri i Kosovës” u mor në mënyrë unanime gjatë mbledhjes së Komitetit Drejtues të organizatës.¹³ Para se të trajtohet roli dhe historiku i gazetës, është thelbësore që për komunitetin e studiuësve të ofrohen të dhëna për origjinën e këtij emërtimi dhe motivet që qëndronin pas tij.

Në diskursin publik dhe në disa studime të hershme është hedhur hipoteza se emërtimi “Zëri i Kosovës” kishte lidhje të drejtpërdrejtë ose ndikim frymëzues nga organi i shtypit të Partisë së Punës së Shqipërisë, “Zëri i Popullit”. Është fakt i pamohueshëm se organizatat e fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë dhe viset shqiptare nën sundimin e Jugosllavisë, kanë pasur lidhje të shumanshme me shtetin shqiptar, në nivele të ndryshme. Sa i përket çështjes së organizimit të shtypit të fshehtë në Kosovë dhe emërtimit të tij, nga të gjitha dokumentet e hulumtuara në arkivat e shtetit shqiptar, deri më tani nuk është gjetur asnjë referencë që të tregojë ndonjë rekomandim apo influencë të jashtme mbi këtë proces. Nga kjo mund të thuhet se nuk ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zgjedhjen e emrit të gazetës “Zëri i Kosovës” në vitin 1974. Ky supozim konfirmohet edhe nga analiza e dokumentacionit të ish-arkivave jugosllave, të cilat, edhe pse shumë prej tyre janë shpërndarë dhe ruhet një pjesë në Slloveni dhe Kroaci, nuk tregojnë ndonjë lidhje me këtë çështje. Po ashtu, dokumentacioni i vetë organizatës, në këtë rast i Grupit Revolucionar të Kosovës, nuk përmban asnjë referencë që lidhet me ndonjë ndikim të jashtëm, në këtë rast të shtetit shqiptar, mbi emërtimin e gazetës.

Si përfundim, bazuar në të gjitha hulumtimet arkivore, por edhe në intervistat dhe bisedat me vetë veprimtarët e organizatës, mund të konkludohet se emërtimi i gazetës “Zëri i Kosovës” ishte krejtësisht origjinal, burimor dhe produkt i vendimeve dhe frymëzimit të drejtuesve të Grupit Revolucionar të Kosovës, pa ndërhyrje apo influencë nga jashtë.

Nga intervistat hulumtuese të zhvilluara me drejtuesin e GRK-OMLK, Mehmet Hajrizin, rezulton se emërtimi i gazetës ishte krejtësisht natyror

¹³ Intervistë me Mehmet Hajrizin, viti 2019. Ndërsa nga konsultim me Xhafer Shatrin, si anëtarë i Komitetit Drejtues të GRK, është deklaruar se nuk i kujtohet se si ka ardhur deri te emërtimi i gazetës, por thotë se ka njohuri se ka qenë vendim unanim. Konsulta është bërë në më 3 qershor të vitit 2023.

dhe i pavarur, pa asnjë lloj ndikimi nga strukturat politike jashtë organizatës “Grupit Revolucionar i Kosovës”.¹⁴ Ky fakt tregon qartë se zgjedhja e emrit nuk ishte e diktuar nga ndonjë orientim ideologjik apo influencë e jashtme, por buronte nga iniciativa dhe frymëzimi i brendshëm i organizatës.

Nga një këndvështrim pragmatik, disa anëtarë të Komitetit Drejtues të kësaj organizate, të cilët ishin arsimtarë, gazetarë ose studentë absolutë, kishin përvojë me “gazetat e murit¹⁵”, që vepronin në kuadër të shkollave gjatë viteve të ’70. Këto gazeta shërbenin për të publikuar aktivitete shkollore, lajmërimi, poezi, vizatime dhe materiale të tjera me karakter edukativ ose artistik të nxënësve, dhe emërtoheshin sipas dëshirës së kolektivit të shkollës, me emra të ndryshëm si “Drita”, “Dituria”, “Mësuesi”, “Pionieri”, etj.

Në këtë kontekst, në një shkollë të një fshati të Kosovës, konkretisht në fshatin Magurë të Lipjanit, kolektivi shkollor kishte zgjedhur, pa ndonjë prapavijë politike apo organizative, emrin “Zëri i Kosovës” për gazetën e murit në shkollën e tyre. Ky fakt tregon se emërtimi kishte një origjinë krejtësisht spontane dhe simbolike, duke reflektuar identitetin kombëtar dhe frymën edukative të kolektivit të shkollës, përpara se të institucionalizohej më vonë si organ agjitativ i GRK-së.

Drejtuesi i organizatës, Mehmet Hajrizi, i cili kishte përfunduar studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe, kishte konkurruar për punësim në dy shkollat përmes një konkursi të shpallur: në fshatin Magurë të komunës së Lipjanit dhe në fshatin Llukar të komunës së Prishtinës. Për shkak të koincidence, ai u pranua në të dy vendet, por sipas ligjit të asaj kohe, duhej të caktohej vetëm për njërin prej tyre. Bazuar në intervistën hulumtuese, ai ishte përcaktuar të punonte si mësues në shkollën e fshatit Llukar të Prishtinës. Për shkak të këtij caktimi, M. Hajrizi duhej të njoftonte kolektivin e shkollës së fshatit Magurë se nuk do të ishte pjesë e tyre për arsye objektive. Gjatë vizitës së tij për të bërë këtë njoftim, ai vuri re “gazetën e murit” të shkollës në fshatin Magurë, e cila ishte emërtuar me titullin “Zëri i Kosovës”.¹⁶

Ky moment, sipas intervistës së ofruar nga Mehmet Hajrizi, kishte pasur një ndikim të thellë mbi të, duke i dhënë një përshtypje të veçantë për iniciativën spontane të kolektivit shkollor. Emërtimi i kësaj “gazetes së murit”, i

¹⁴ Intervistë me Mehmet Hajrizin, drejtues i organizatës GRK-OMLK, intervista është zhvilluar në janar të vitit 2019.

¹⁵ Gazeta e murit ka qenë praktikisht tabelë prej dërrase, e vendosur në korridoret e shkollës dhe jo ndonjë formë gazete e shtypur.

¹⁶ Intervistë me Mehmet Hajrizin, janar, 2019.

realizuar pa ndonjë orientim politik apo ndikim të jashtëm, reflektonte frymën kombëtare dhe vetëdijen qytetare të nxënësve dhe kolektivit të shkollës, duke lënë gjurmë në perceptimin e Mehmet Hajrizit mbi rolin simbolik dhe edukativ të kohës. Gjatë fazës së përgatitjes së organit të saj të shtypit, në mbledhjen e Komitetit Drejtues të GRK-së u propozuar emërtimi i gazetës “Zëri i Kosovës”, i cili ishte pranuar si organ agjitativ i organizatës dhe ishte miratuar në mënyrë unanime nga Komiteti Drejtues i saj.¹⁷ Bazuar në këto të dhëna, procesi i emërtimit të gazetës u zhvillua në mënyrë krejtësisht natyrale, pa ndonjë ndërhyrje të jashtme ose sforcim të vendimit. Mirëpo, emri, misioni dhe përmbajtja e gazetës lanë gjurmë historike, duke e bërë atë një organ agjitativ klandestin me jetëgjatësi të konsiderueshme në Kosovë dhe në viset e saj të pushtuara nën Jugosllavi, si mjet i rëndësishëm i komunikimit dhe mobilizimit të masave të gjera popullore¹⁸. Në këtë kontekst, ndikimi që pati numri i parë i gazetës “Zëri i Kosovës”, më 1 shkurt 1974, rezultoi të ketë qenë veçanërisht domethënës, si në mobilizimin ideopolitik, ashtu edhe në ndërgjegjësimin e opinionit publik, çka do të analizohen në njësitë e mëposhtme të këtij studimi.

Numri i parë i gazetës “Zëri i Kosovës”, si organ agjitativ i Grupit Revolucionar të Kosovës-GRK, u përgatit dhe u shtyp në rrethana jashtëzakonisht të rënda dhe nën një konspiracion të thellë. Ky proces u realizua nga një grup i vogël veprimtarësh të organizuar të GRK-së, duke përdorur mjete teknike kryesisht improvizuese dhe me një numër të kufizuar ekzemplarësh, të cilët nuk mund të përcaktohen me saktësi¹⁹.

Përkundër këtij kufizimi të tirazhit, publikimi i këtij numri të parë shkaktoi një tronditje politike në të gjitha shtresat e shoqërisë dhe jo vetëm. Efekti i saj nuk kufizohej vetëm te masat e gjera popullore, por përfshiu gjithashtu aparatit shtetëror të nivelit federativ, republikan dhe krahinor, i cili u mobilizua për të zbuluar organizatorët e botimit. Kjo gjë shërbeu dhe si një barometër i qartë i ndikimit që kishte organizata GRK dhe organi i saj agjitativ, “Zëri i Kosovës”, duke reflektuar jo vetëm potencialin mobilizues të komunikimit të fshehtë, por edhe rëndësinë historike dhe politike të shtypit

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Kjo gazetë me emrin “Zëri i Kosovës, është shtypur në mënyrë të fshehtë si organ agjitativ dhe i organizatës pasuese, “Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës” më vonë “Lëvizja Popullore e Kosovës, deri në vitin 2000, pas çlirimit përfundimtar të Kosovës. Si e tillë kjo gazetë ka qenë organ agjitativ i luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

¹⁹ Të dhëna rrethanore, referojnë se numri i parë nuk ka qenë më i madh se 20 ekzemplarë.

klandestin në kontekstin e atyre viteve. Për më tepër, organet represive të federatës jugosllave kishin ngritur trupa punuese ekspertësh për të analizuar shkrimet e botuara në kuadër të kësaj gazete të fshehtë në shumë segmente të ndryshme. Këto analiza përfshinin karakterin e shkrimeve, përmbajtjen, stilin e shkrimit, sintaksën, morfologjinë gramatikore dhe deri te shenjat e pikësimit. Qëllimi i tyre ishte të arrinin deri të një deshifrim i mundshëm i personave që udhëhiqnin organizatën, por dhe nivelin përgatitor të drejtuesve të saj, qoftë nga pikëpamja teorike, qoftë nga ajo praktike, si dhe të mundësohej identifikimi dhe arrestimi i tyre.

Në këtë kontekst, organizata e fshehtë me karakter çlirimtar “Grupi Revolucionar i Kosovës”-GRK u evidentua si një organizatë e cila me veprimtarinë e saj kishte dhënë efektin e duhur për realizimin e misionit për të cilin ishte themeluar, ideuar dhe strukturuar në mënyrë të thellë, duke pasur si bazë programin e saj politik, i cili më vonë u botua nën titullin: “Në rrugë drejt lirisë”, i hartuar në vitin 1978.²⁰

Në këtë periudhë, me veprimtarinë e saj, organizata GRK dha sinjale të rëndësishme. Ajo organizoi një sistem komunikimi të fshehtë me masat e gjera popullore, i cili, përveç proklamimit të kauzës që përfaqësonte, kundërshtonte gjithashtu organet e informimit zyrtar jugosllav, qoftë atë të shkruar, viziv apo fonik. Si e tillë, kjo gazetë u bë antipod i shtypit zyrtar jugosllav. Ajo dalonte për nga përmbajtja tematike, forma dhe ideologjia e saj, duke reflektuar një filozofi nacional-çlirimtare.

Në të gjithë numrat e saj të shtypur, artikujt informues, analizat dhe reagimet e botuara shprehin qartë qëndrimin e organizatës. Siç shkruan në një nga artikujt e shumë të saj: “Shtypi jugosllav shtrembëron faktet historike, mohon traditën kombëtare të popullit tonë”.²¹ Ky citim dëshmonte se misioni kryesor i gazetës dhe i vetë organizatës GRK-së ishte ngritja e ndërgjegjes kombëtare të të gjitha shtresave shoqërore shqiptare, me një fokus të veçantë te brezi i ri, si shtresë më revolucionare e shoqërisë, që në kuadër të kësaj shtrese të rinisë, ishin dhe vetë veprimtarët e organizuar dhe drejtuesit e kësaj organizate.

Sipas analizave empirike të kryera mbi proceset gjyqësore të të dënuarve politikë shqiptarë në ish-Jugosllavi, përfshirë anëtarët e GRK-OMLK-së dhe të organizatave të tjera më të vonshme, vihet re se mosha mesatare e veprim-

²⁰ ASHAK, Ekzemplarë i gjetur të platformës politike “Në Rrugë Drejt Lirisë”, Fondi: Gjykatat e Qarkut Prishtinë, Njësia Organike: Penale, Nr. R. 74, Nr. L. 69, viti 1982.

²¹ Zëri i Kosovës, Nr. 1, 1 shkurt 1974, f. 2.

tarëve dhe veprimeve të organizuara, përfshirë edhe drejtuesit, nuk e kalonte moshën 24 vjeç.²² Pjesa më e madhe e tyre ishte studentë, me përjashtime të vogla, ku kishte dhe arsimtarë të shkollave, gazetarë të rinj dhe profesionistë që sapo kishin filluar punën.

Në këtë kontekst, organizimi i një shtypi të fshehtë ishte jashtëzakonisht sfidues. Rrethanat në të cilat vepronte organizata “Grupi Revolucionar i Kosovës”²³ ishin tepër delikate dhe të ndërlikuara në shumë fusha: mungesa e mjeteve teknike për shtyp, mungesa e përvojës në përgatitjen e gazetës, sigurimi i konfidencës dhe përballimi i shumë sfidave të tjera operative. Kështu, ndërmarrja e një organizate me karakter çlirimtar për të pasur mekanizmat e veta komunikues me masat e gjera popullore, dhe për t’iu kundërpërgjigjur shtypit zyrtar jugosllav dhe vetë sistemit jugosllav, përbënte një sfidë jo të thjeshtë, por të shumëfishtë dhe komplekse në tërësi. Ajo kërkonte mobilizim maksimal, disiplinë strikte dhe një angazhim të pakompromis ndaj kauzës kombëtare.

Studiuesja Rudina Zeqiri, në një nga studimet e saj me vlerë të konsiderueshme në këtë fushë, argumenton se “anëtarët e “Grupit Revolucionar të Kosovës” kishin arritur të realizonin një kombinim artizanal të shaptilografëve të parë duke bashkuar pjesë të ndryshme për shtypin e gazetës. Megjithatë, për të arritur efikasitet maksimal në përputhje me objektivat që i kishin caktuar vetes, organizata u detyrua të ndërmarrë aksione të sigurimit të mjeteve teknike për traktet dhe shtypin klandestin”²⁴. Sipas autores Zeqiri, “...për këtë qëllim duheshin pajisje specifike si shaptilografët e mëdhenj elektrikë, gështetnerët mekanikë, ngjyra, makina e shkrimit, letra dhe letra amzat. Duke qenë se disa nga këto mjete nuk mund të bliheshin pa leje speciale, blerja eventuale do të dekonspironte aktivitetin e fshehtë... Si rrjedhojë, aktivistët, pas një planifikimi të detajuar, ndërmerrnin aksione të fshehta në institucionet ose ndërmarrjet e pakta që zotëronin këto mjete”. [...] Procedura përfshinte hyrjen natën në institucionet shtetërore ose ndërmarrjet e

²² Arkivi i Shoqatës së të Burgosurve Politik të Kosovës, studim mbi dosjet të të dënuarve politik nga pikëpamja e moshës, gjinisë dhe statusit shoqëror.

²³ Po i referohem GRK-së, sepse ishte organizata e parë me karakter çlirimtar që e filloi shtypin e fshehtë brenda Kosovës, siç ishte “Zëri i Kosovës, “Pararoja”, dhe së fundmi gazeta “Liria”. Më vonë këtë tip të shtypit e kanë realizuar dhe organizatat e tjera siç ishte LNCKVSH, jashtë vendit, e veçanërisht Jusuf Gërvalla. Pastaj Fronti i Kuq Popullorë që drejtohej nga Ibrahim Kelmendi me gazetën “Bashkimi”, dhe dy numra të organizatës PK-MLSHJ-së me gazetën Revolucionari.

²⁴ Rudina Zeqiri, *Format Specifike të Komunikimit...*, f. 42.

*përzgjedhura, kërcënimin e rojës, nëse ishte i pranishëm, dhe sigurimin e pajisjeve si shaptilografët, të cilët ngarkoheshin dhe transportoheshin me kujdes drejt bazës operative. Ky proces dëshmonte guximin e jashtëzakonshëm, sakrificën e madhe dhe pjekurinë politike të veprimtarëve të GRK-së, duke reflektuar kompleksitetin dhe rrezikun e jashtëzakonshëm të veprimtarisë së tyre ilegale”.*²⁵

Megjithatë, pavarësisht sfidave, rreziqeve dhe sakrificave të jashtëzakonshme, organizata “Grupi Revolucionar i Kosovës” e kishte realizuar misionin e saj në mënyrë të qëndrueshme dhe të natyrshme, sipas objektivave të parapara të themelimit të saj. Veprimtarët e saj treguan aftësinë për të ruajtur vijimësinë ideopolitike dhe operacionale të kauzës çlirimtare, duke kultivuar dhe përforcuar farën e mbjellë nga organizatat atdhetare pararendëse.

Në këtë kuadër, GRK-ja nuk ishte vetëm që përmbushi misionin e saj, por edhe krijoi një trashëgimi të qëndrueshme që u trashëgua nga organizata të mëvonshme, të cilat e vazhduan këtë linjë aktiviteti, siç ishte organizata politiko-ushtarake “Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës”- LPRK/LPK. Kjo vazhdimësi dëshmon jo vetëm ndikimin e drejtpërdrejtë të GRK-OMLK-së në proceset e mobilizimit politik dhe nacional, por edhe rolin e saj themelor në konsolidimin e veprimtarisë së fshehtë dhe të shtypit të fshehtë me karakter çlirimtar në Kosovë.

Veprimtaria e GRK-OMLK-së përbën një shembull të qartë të një organizate të vogël, por me ndikim të thellë, e cila, duke punuar në rrethana ekstreme, kontribuoi në forcimin e vetëdijes kombëtare dhe krijimin e infrastrukturës ideopolitike dhe praktike që do të pasqyrohej në veprimtaritë e organizatave pasuese që e trashëguan atë.

Megjithatë, organizimi i një shtypi të fshehtë me karakter çlirimtar dhe antijugosllav në rrethanat e asaj kohe; me mungesë të rëndësishme të mjeteve teknike; nën një veprimtari të thellë në fshehtësi për shkak të reprezaljeve të aparatit shtetëror jugosllav, ishte një ndërmarrje me natyrë thuajse vetëflijues. Ata që e konceptuan, përgatitën dhe vunë në jetë këtë mekanizëm komunikimi me masat e gjera popullore e bënë këtë me vetëdije të plotë për rreziqet, deri edhe për sakrificën e jetës së tyre dhe të familjeve të tyre, me qëllim rritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe përgatitjen për një rezistencë të organizuar në kohën e duhur. Nëse krahasohet me rrethanat bashkëkohore të sotme, ku themelimi i një mediumi është i ligjshëm, teknologjia është e

²⁵ Po aty, f, 43.

avancuar dhe ekzistojnë mundësi financimi e sponsorizimi, përsëri nuk mund të mohohet se edhe sot drejtimi i një mediumi është veprim i vështirë dhe pa garanci suksesi. Megjithatë, përkundër kushteve ekstreme të veprimtarisë së fshehtë anti-jugosllave për gjatë viteve '70-'80, shtypi i fshehtë i organizatave çlirimtare, dhe veçanërisht iniciativa e GRK-OMLK, arriti të përm-bushë misionin e vet: të krijonte ndikim ideopolitik, të mobilizonte shtresa të gjera popullore dhe të ruante vijimësinë politike dhe kulturore në shërbim të kauzës kombëtare. Kështu, pavarësisht vështirësive operative dhe rrezi-kut permanent, veprimtaria e shtypit të fshehtë dëshmoi pjekuri organizative dhe vendosmëri politike. Ai mbeti një faktor kyç në konsolidimin e vetëdijes kombëtare dhe la një trashëgimi të paçmuar që do të ndikonte në formën dhe strategjinë e lëvizjeve pasuese për çlirimin e Kosovës.

Përgatitja dhe përmbajtja tematike e shtypit të fshehtë

Në kuadër të përgatitjes së shtypit të fshehtë, procesi konceptual dhe tematik ishte i strukturuar dhe i qartë. Fillimisht, brenda radhëve përgjegjëse të organizatës bëhej përzgjedhja e temave, të cilat domosdoshmërisht ishin të lidhura me kauzat e caktuara të organizatës. Zgjedhja e temave ishte e kujdesshme dhe e synuar për të garantuar koherencë ideopolitike dhe saktësi argumentuese.

Sipas drejtuesit të organizatës, Mehmet Hajrizi, “për secilin shkrim të mundshëm përcaktohej literatura konsultative, duke u bazuar në njohuritë dhe kapacitetet analitike të veprimtarëve të organizuar. Secili përgjegjës i fushës agjitativë merrte një temë për të cilën ishte i përgatitur dhe kishte njohuri të mjaftueshme për ta elaboruar si në formën verbale, ashtu edhe në atë të shkruar. Në përfundim të secilit shkrim, artikujt diskutoheshin në mbledhjet e radhës të celulës përkatëse, ku bashkëveprimtarët ishin të detyruar të jepnin sugjerime dhe vërejtje me qëllim që artikulli të ishte sa më i plotë dhe të shmangte gabime të çdo lloji”.²⁶ “...Në këtë mënyrë, temat mbeteshin të lira, por gjithmonë të lidhura ngushtë me platformën politike të organizatës, duke garantuar jo vetëm koherencë dhe saktësi ideopolitike, por edhe një strukturë funksionale dhe disiplinë pune në radhët e veprimtarëve të shtypit klandes-tin”.²⁷

²⁶ Mehmet Hajrizi, *Historia e një Organizate politike dhe Demonstratat e Vitit 1981*, Botime Toena, Tiranë 2008, f. 78.

²⁷ Po aty.

Një rigorozitet i tillë, në kuadër të një veprimtarie thellësisht të fshehtë, anti-jugosllave dhe me karakter çlirimtar, nuk ishte pa synim. Ai synonte të tejkalonte kufijtë bazë informues.²⁸ Në këtë kontekst, organizata atdhetare, siç ishte GRK-OMLK, synonte të përmbyste propagandën e medimeve shtetërore jugosllave, përfshirë gazeta dhe radio televizione, të cilat, përmes propagandës së tyre, kishin qëllim të deformonin çdo element identitar shqiptar, duke e kamufluar me një ideologji hibride. Andaj, nëse ia bëjmë një analizë përmbajtësore shtypit të fshehtë, duke u hequr disa terma që përdorshin në kontekstin kohor dhe që reflektonin rezonancën e lëvizjeve çlirimtare në nivel global, vërejmë një tip të shtypit, i cili në esencë nuk dallonte nga filozofia dhe ideologjia e periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kjo bëhet e qartë kur i krahasojmë shkrimet dhe artikujt e shtypit të fshehtë me shkrime të autorëve të njohur të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, siç ishin Sami Frashëri, Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, etj., të cilët kishin ndërtuar një vizion të qartë kombëtar dhe një strategji edukative dhe mobilizuese për kombin shqiptar në mbrojtje të të drejtave të tyre. Pra, shtypi i fshehtë nuk përbënte thjesht një mjet informimi, por një instrument strategjik për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar, për edukimin ideopolitik të brezave të rinj dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj propagandës shtetërore jugosllave. Ai, në thelb, përcillte mesazhe që kontribuonin në formimin e një vetëdijeje historike dhe politike të ndërtuar mbi themelet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, me theks të veçantë në platformën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në bazë të këtyre krahasimeve, me të drejtë Mehmet Hajri referon se “shtypi i fshehtë rreshtohet në kuadër të shtypit misionar”²⁹, i cili në thelb synoi dhe arriti të nxiste dhe të ndikonte potencialin patriotik, revolucionar, intelektual dhe punëtor, duke shtuar radhët e atyre që i besonin filozofisë çlirimtare. Për realizimin e këtij misioni, drejtuesit e GRK-OMLK-së, vërejtën se organizimi i një shtypi me karakter antipushtues dhe anti-jugosllav, “...jo vetëm që kërkonte veprimtarë të guximshëm dhe konspirativ, por ai kërkon një mobilizim të njerëzve të dijes e të penës...”³⁰. “...Synimi i tij kishte për qëllim që të tejkalonte radhët e veta dhe të jepte një ndikim në masat e gjera popullore, sidomos në formësimin teorik dhe në atë të mobilizimit të një luftë çlirimtare...”³¹ Ky objektivi pasqyrore një strategji të qartë revolucionare në

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty.

afirmimin e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë dhe viset e saj, që gjendeshin nën sundimin e Jugosllavisë, duke synuar kapërcimin e kufijve të një organizate të ngushtë apo të një rrethi të veprimtarëve të drejtpërdrejtë, por drejt zgjerimit të ideve dhe ndikimit të tyre drejt masave të gjera popullore.

GRK-OMLK synonte jo vetëm edukimin teorik të aktivistëve të saj të organizuar, që padyshim shërbente për ndërtimin e një baze të fortë ideopolitike, por edhe formimin politik të shtresave të caktuara të shoqërisë, duke i frymëzuar për të kuptuar padrejtësitë dhe nevojën për veprim kombëtar dhe çlirimtar.

Në këtë kontekst, botimi që nga numri i parë i gazetës “Zëri i Kosovës” si organ agjitativ i GRK-së në vitet 1974-1975, dëshmoi qartësisht këtë mision. Artikujt e botuar në këtë periudhë kishin karakter të thirrjes për rizgjim të ndërgjegjes kombëtare shqiptare, një ndërgjegje që shtypi zyrtar jugosllav nuk lejonte të manifestohej. Në një nga artikujt e saj shkruhej: “...nën parullën e vëllazërim-bashkimit mbi popullin shqiptar në Jugosllavi u luajt loja e diskriminimit nacional dhe e asimilimit të plotë. Krahas mohimit të lirive të tjera, popullit tonë iu mohua edhe liria e shtypit... Ata që shprehnin haptas ndjenjat e tyre mbylleshin dhe, në disa raste, zhdukeshin... Shtypi jugosllav shqetësimet e masave i kamufilon me dredhi, ndërsa dëshirat varrosen...”³²

Në thelb, artikulli ilustron qartësisht qëndrimin e organizatës së fshehtë me karakter çlirimtar kundrejt dogmave dhe doktrinave artificiale jugosllave, siç ishte doktrina e “Vëllazërim-Bashkimit” për popujt që e përbënin federatën jugosllave. Nga njëra anë, artikulli kundërshtonte këtë doktrinë të imponuar, ndërsa nga ana tjetër godiste cezurën dhe manipulimin mediatik të sistemit jugosllav, i cili kishte për qëllim krijimin e një identiteti të ri, një identitet të mundshëm të krijimit të kombit jugosllav, duke fshirë dhe deformuar identitetin e vërtetë kombëtar shqiptar.³³

Në shtypin e fshehtë, që në zanafillën e tij, prej viteve 1970 e deri në përfundim të luftës së përgjithshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjitha shkrimet janë përgatitur nga vetë veprimtarët e këtyre organizatave dhe, pa përjashtim, përbëjnë thelbin bazë të platformës politike të këtyre organizatave

³² Zëri i Kosovës, “*Fjala e Hyrjes*”, Nr. I, datë 1. Shkurt 1974; ASHAK, Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, kutia Nr. 12, f. 91, viti 1982.

³³ Dhe një nga parullat në kuadër të demonstratave të përgjithshme shqiptare të vitit 1981, shkruhej, “jemi shqiptarë, jo jugosllav”. Kjo parullë, ishte si kundër përgjigje ndaj regjistrimit të popullsisë së vitit 1981, ku organet reprezive jugosllave, bënë presion që shqiptarët të regjistroheshin si kombësi jugosllave, jo shqiptare.

anti-jugosllave, të cilët përhapeshin përmes këtij shtypi të fshehtë.³⁴ Shkrimet janë artikulluar me një patos patriotik dhe një forcë shprehjeje të pasuruar me koloritin e gjuhës së unifikuar shqipe. Ato karakterizohen nga thjeshtësia e shprehjes dhe aftësia për orientim e analizë, që u jepte lexuesve një kuptim më të avancuar të ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Këto shkrime pasqyrojnë dhe njohuritë më të thella lidhur me filozofinë çlirimtare të organizatës së fshehtë me karakter çlirimtar, “Grupi Revolucionar i Kosovës” (GRK-OMLK), e cila ishte trashëguar nga brezat e veprimtarisë së mëhershme dhe synonte të shtrihej te brezat e ardhshëm. Ato shkrime për kohën nuk ishin thjesht shkrime me përmbajtje politike, por kishin dhe funksionin e instrumenteve të fuqishme edukative dhe ndërgjegjësuese, të destinuara për të formuar një perceptim të qartë ideopolitik dhe patriotik te shtresat e reja të shoqërisë shqiptare në Kosovë dhe territoret e saj nën sundimin e Jugosllavisë. Përmes këtyre shkrimeve, veprimtarët e GRK-OMLK-së krijuan një bazë ideopolitike të qëndrueshme, që do të frymëzonte brezat e ardhshëm për luftën e pandalshme për liri, barazi dhe afirmim të identitetit kombëtar, ndaras nga përkatësitë e tjera etnike që përbënin federatën jugosllave.

Në kuadër të këtij shtypi të fshehtë trajtoheshin teza të ndryshme që pasqyronin dimensione të thella të veprimtarisë organizative dhe ideopolitike. Ato fillonin me analiza kritike mbi format dhe praktikat e organizimit të lëvizjeve të fshehta çlirimtare, vazhdonin me shqyrtimin e veprave të filozofisë klasike³⁵, udhëzime për konspiracionin³⁶, punën me celulatat revolucionare dhe zgjerimin e radhëve³⁷, disiplina dhe strukturat brenda organizatës³⁸, si dhe kritika dhe autokritika të brendshme³⁹. Po ashtu, këtu përfshiheshin trajtime mbi metodat e luftës së fshehtë⁴⁰, ushtrime për përforcimin e konspiracionit, si dhe çështje të rëndësishme për agjitacionin dhe propagandën, duke theksuar domosdoshmërinë e zgjerimit të radhëve si detyrë thelbësore për organizatën.⁴¹

Këto teza dëshmojnë se organizata e fshehtë me karakter çlirimtar, “Grupi Revolucionar i Kosovës” (GRK-OMLK), kishte arritur të thyente barrierat

³⁴ Mehmet Hajrizi & Gani Syla, “*Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës*”, f, 21-34.

³⁵ Zëri i Kosovës, Nr, 1, shkurt të vitit 1974, f, 6.

³⁶ Mehmet Hajrizi & Gani Syla, “*Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës*”, f, 46-47.

³⁷ Zëri I Kosovës, Nr, 1, shkurt të vitit 1974, f, 11-18.

³⁸ ASHAK, Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësia Organike: Penale, Nr. R. 74, Nr. L. 69, op.cit, “Materiale”.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Zëri i Kosovës, Nr, 2, prill 1974, f, 4-8.

⁴¹ Pararoja, organ agjitativ i Grupit Marksist Leninist të Kosovës, dhjetor 1979.

dhe tabutë e propagandës zyrtare jugosllave, e cila shpesh paraqitej si e pa-prekshme dhe absolute. Përmes këtyre shkrimeve, organizata nuk kufizohej vetëm në veprimtari të fshehtë të brendshme, por gjithashtu zhvillonte një sistem edukativ dhe mobilizues për masat e gjëra popullore të asaj kohe, duke e kthyer teorinë në instrument praktik për ndërgjegjësim dhe mobilizim politik.

Siç e trajtuam më lart, këto teza u shndërruan më vonë në forma të komunikimit me masat e gjera, duke u botuar si broshura xhepi që kanë qarkulluar në kuadër të veprimtarisë anti-jugosllave dhe çlirimtare, deri në vitin 1989.⁴² Kjo tregon qartësisht jo vetëm konsistencën ideopolitike dhe strategjike të organizatës, por edhe aftësinë për ta përshtatur mekanizmin informativ me atë pedagogjik, për të rritur ndikimin politik nga perspektiva atdhetare në të gjithë masat e gjera popullore shqiptare që jetonin në sundimin jugosllav. Tema kryesore e të gjithë artikujve të shtypit të fshehtë lidhej me çështjen e padrejtësive ndaj shqiptarëve nën Jugosllavi, të cilëve u mohoheshin të drejtat e tyre në të gjitha nivelet e jetës kombëtare, duke cenuar identitetin e tyre të lashtë dhe autokton në trojet e tyre.

Duke qenë të vetëdijshëm, për pamundësinë për të zhvilluar veprimtari politike të hapur, organizata “Grupi Revolucionar i Kosovës” (GRK-OM-LK), por edhe organizata të tjera të mëvonshme, e përdorën shtypin e fshehtë si fazën më të lartë të komunikimit me masat e gjera popullore. Qëllimi i tyre ishte të arrinin deri tek të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare që jetonin nën sundimin e Jugosllavisë, duke nxitur një rizgjim të gjithanshëm kundër shtypjes dhe asimilimit. Gjatë përgatitjes së artikujve, debate të thella zhvilloheshin mes veprimtarëve për të garantuar se çdo material agjitativ do të ishte në funksion si mjet frymëzimi, edukimi dhe mobilizimi i masave të gjera popullore për luftë çlirimtare. Sipas një artikulli të këtij shtypi, lidhur me këtë çështje theksohet se në kuadër të diskutimeve të brendshme, veprimtarët e organizuar vendosnin se: “Duhet ta kemi gjithmonë në mendje se duhet të jemi frymëzues, edukues dhe mobilizues të masave të gjera popullore. Për t’u lidhur mirë me to, duhet të krijojmë celula të reja”⁴³. Kjo qasje tregon qartësisht ndërveprimin midis edukimit ideopolitik dhe veprimit praktik për zgjerimin e rrjetit organizativ në nivelin e masave të gjera popullore për veprimtari anti-jugosllave.

⁴² ASHAK, Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësia penale, Nr. R. 4- Nr. L. 4, viti 1989.

⁴³ Zëri i Kosovës, “*Cështje Agjitacionit dhe Propagande*”, Nr.2. Prill, 1974.

Siç e kemi theksuar në fillim, tirazhet ishin mjaft të kufizuara, vetëm dhjetëra ekzemplarë, për t'u rritur më vonë. Për shkak të pamundësive teknike dhe rrezikut të lartë operativ, shpërndarja organizohej dorë më dorë⁴⁴ dhe vetëm brenda rrjeteve të besuara, në mjedise ku ishin krijuar paraprakisht kushte mirëbesimi.

Përmbajtja e artikujve të shkruar, kur lexohen nga perspektiva e sotme, reflektonte një ndjenjë të thellë dhimbjeje të këtyre veprimtarëve për fatin kombëtar, duke e kthyer këtë dhimbje në thirrje për bashkim, organizim dhe veprim përbashkues për çlirimin e trojeve shqiptare që gjendeshin nën sundimin e Jugosllavisë. Pa përjashtim, gjuha e shkruar e përdorur në kuadër të këtyre artikujve është gjuha e unifikuar standarde, e pasuruar me kolorit patriotik dhe e orientuar drejt mobilizimit. Mesazhet që përcillnin këto shkrime u drejtoheshin jo vetëm intelektualëve, por edhe shtresës punëtore dhe fshatarësisë, duke synuar të nxisnin gatishmërinë për rezistencë. Shembuj të botuar janë artikujt: "Liri ose vdekje!" si dhe analiza kritike "Kushtetuta dhe Realiteti"⁴⁵, të cilat dëshmojnë qartë për qëllimin e dyfishtë: denoncimin e mashtrimit të propagandës jugosllave dhe nxitjen e ndërgjegjësimit politik shqiptar.

Çdo shkrim shqyrtohej dhe diskutohej në nivele përkatëse të organizatës. Artikujt që do të publikoheshin duhej të reflektonin pjekuri politike, organizative dhe koherencë me filozofinë çlirimtare që GRKOMLK kishte trashëguar nga lëvizjet e mëparshme anti-jugosllave si dhe nga aktet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare⁴⁶.

Pra, nga këndvështrimi historik dhe metodologjik, shtypi i fshehtë i këtyre viteve duhet studiuar si një mekanizëm i integruar edukativo-politik brenda organizatave të fshehta me karakter çlirimtar. Ai, për kohën, dokumentonte gjendjen e shqiptarëve nën sundimin e Jugosllavisë, artikulonte një platformë ideopolitike dhe vepruese, si dhe përbente një instrument të fuqishëm për zgjimin kombëtar shqiptar në Kosovë dhe në trevat e saj. Artikulli "Kushtetuta dhe Realiteti" nuk mund të merret vetëm si një kritikë e sipërfaqshme e sistemit jugosllav. Ai zbulonte strukturën represive të shtetit, duke ekspozuar regjimin policor dhe mekanizmat e tjerë të shtypjes që fshiheshin pas pari-

⁴⁴ Ka ekzistuar parulla e njohur dhe shkruar: "Merre, lexoje, shpërndaje dhe mos të i bien në dorën e armikut".

⁴⁵ Zëri i Kosovës, Nr.2. Prill, 1974.

⁴⁶ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, (Memorandume, vendime, protesta, thirrje)*, përgatitur nga Sefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Akademia e Shkencave të RSP të Shqipërisë- Instituti I Historisë, Tiranë 1978, f, 82.

meve të shpallura në nenet kushtetuese. Në kuadër të këtij shkrimi haset edhe një shprehje metaforike: “korbat që krrokatin mbi popullin si mbi gjahun e tyre”⁴⁷, e cila nuk duhet parë thjesht si një retorikë, por si një mënyrë për t’i bërë lexuesit të perceptonin dhunën e fshehtë shtetërore dhe manipulimin ideologjik të informacionit nga komunizmi jugosllav. Në aspektin organizativ, këto shkrime nuk botoheshin thjesht në mënyrë sporadike. Ato diskutoheshin paraprakisht brenda organeve drejtuese të organizatës GRKOMLK, duke reflektuar një pjekuri të konsiderueshme politike dhe metodologjike. Çdo artikull synonte, para së gjithash, të edukonte aktivistët e organizuar, të shpjegonte veprimet represive shtetërore jugosllave dhe të mobilizonte masat, duke i lidhur veprimet konkrete me një platformë më të gjerë ideopolitike që trashëgonte frymën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare⁴⁸.

Pra, nga perspektiva e analizës historike, këto shkrime duhet parë si pjesë programatike e platformës kombëtare-çlirimtare. Ato përfaqësonin një kombinim të edukimit politik, mobilizimit popullor dhe dokumentimit kritik të një shtetit represiv. Ai nuk duhet parë thjesht si një “gazetë” në kuptimin formal të fjalës, por si një instrument strategjik dhe misionar i veprimtarisë çlirimtare. Në këtë kuadër, ky shtyp ishte një armë ideopolitike dhe propagandistike, që shërbente për të ndërgjegjësuar masat e gjëra popullore, për të dokumentuar padrejtësitë e regjimit jugosllav dhe për të mobilizuar një rezistencë të strukturuar, me synim çlirim dhe bashkimin kombëtar.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i këtij shtypi është liria relative e mendimit kritik që ofronte⁴⁹. Ai shtrihet në një gamë të gjerë tematike: analiza filozofike dhe socio-politike të çështjes shqiptare nën Jugosllavi; analiza të diskriminimit ekonomik nga federata në raport me Kosovën. Në rrafshin e kulturës, aty gjejmë të botuar proza dhe poezi të frymëzuara nga ndjenja kombëtare; kritika dhe sarkazëm ndaj politikave represive, të shoqëruara me karikatura dhe ilustrime ironike⁵⁰; tekste që promovonin mendimin kritik, debat ideor dhe qasje kreative në kuadër të rezistencës⁵¹.

⁴⁷ Zëri i Kosovës, Nr. 2, f. 3.

⁴⁸ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912...*, f. 82.

⁴⁹ Mehmet Hjarizi, Recension mbi librin e autores, Rudina Zeqiri, “*Format specifike të komunikimit të organizatave të fshehta shqiptare gjatë monizmit jugosllav*”, f. 10.

⁵⁰ ASHAK, Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësia Organike: Penale, Nr. R. 74, Nr. L. 69, “Këngët e lirisë”, përmbledhje tekstesh poezisë, tekste këngësh dhe proza, arti i karikaturës, të botuar nga Grupit Marksist Leninist të Kosovës.

⁵¹ Po aty.

Kjo liri mendimi, brenda organizatës, nuk ishte thjesht një vlerë estetike, por një mjet efektiv mobilizues duke krijuar ura lidhëse në mes veprimtarisë së organizatës dhe lexuesit, që bënë të nënkuptonin absurdin dhe padrejtësitë e regjimit komunist jugosllav; të identifikonin pikat e dobëta të propagandës jugosllave dhe të ndërtonin një strategji të bashkimit dhe rezistencës kombëtare. Ndaj, si i tillë, shtypi i fshehtë nuk mund të shtjellohet dhe as të studiohet në mënyrë të shteruar brenda një studimi të këtij formati, madje as të përmblihet në vija të trasha. Trajtimi i tij, sado i kufizuar, mbetet i domosdoshëm për të kuptuar format e rezistencës politike të shqiptarëve në Kosovë dhe viseve të saj, në rrethana të shtypjes nga federata jugosllave, si dhe për të ndriçuar një dimension thelbësor të veprimtarisë kombëtare të organizatave të fshehta me karakter çlirimtar.

Megjithatë, para se të parashtrijmë pyetjen e tretë hulumtuese, e cila lidhet me ndikimin dhe rëndësinë e këtij shtypi, në formë të sintetizuar do të bëjmë një vlerësim paraprak të tij, gjithmonë në kontekstin historik të kohës kur ai nisi dhe u masivizua si formë komunikimi me masat e gjera popullore, e cila u trashëguua dhe vazhdoi deri në çlirimin e plotë të Kosovës në vitin 1999. Me të drejtë, shumë studiues të kësaj fushe e konsiderojnë këtë tip të shtypit si shtyp me karakter nacional-çlirimtar⁵², për shkak të misionit të tij dhe kontekstit kur aplikohet, pavarësisht nga kushtet e vështira, qoftë gjatë përgatitjes teknike brenda vendit, qoftë jashtë tij, dhe gjatë gjithë jetës së tij. Ka edhe nga ata që këtë lloj shtypi nuk e kanë studiuar apo analizuar siç duhet, por guxojnë të shkruajnë teza mbi veprimtarinë e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar, duke i cilësuar ato si kundërrevolucionare, nacionaliste ose irredentiste, pa u mbështetur në dokumente apo prova empirike.

Në radhë të parë, nga një analizë krejtësisht e thjeshtë, nëse bëhet një lexim krahasues midis shtypit me karakter indoktrinues të Federatës Jugosllave dhe shtypit të fshehtë të organizatave me karakter çlirimtar, për sa i përket përmbajtjes, nivelit intelektual të autorëve dhe rolit të tyre në komunikimin me masat e gjera popullore, del qartë se Grupi Revolucionar i Kosovës, më vonë Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, si dhe të gjitha organizatat e tjera të fshehta atdhetare të mëvonshme nën ombrellën e LPRK/LPK, nuk kanë pasur kompleksitet të inferioritetit ndaj aparatit të regjimit jugosllav. Përkundrazi, ato dëshmojnë vetëdije të lartë mendimi dhe një kurajë

⁵² Konsultim me veprimtarin dhe studiuesin Bardhyl Mahmutin dhe Ramadan Avdiu lidhu me tipologjinë e komunikimit të organizatave të fshehta me karakter çlirimtar, me masat e gjera popullore të organizatave të fshehta.

të jashtëzakonshme në marrjen e qëndrimeve, veçanërisht në gjykimin dhe dekonstruktimin e politikës represive jugosllave, si dhe në demaskimin e saj në të gjitha drejtimet kundër shqiptarëve.

Siç thekson drejtuesi i organizatës GRK-OMLK, Mehmet Hajrizi: “Ky shtyp karakterizohet nga fuqia argumentuese, demaskuese dhe polemizuese, si dhe nga mesazhi i saj mobilizues”.⁵³

Në anën tjetër, shtypi zyrtar jugosllav, i cili propagandonte një ideologji të kontrolluar, e instrumentalizonte informacionin me synim për të krijuar një identitet të përbashkët jugosllav. Në këtë kontekst, mund të ofrohen mijëra faqe të shtypit zyrtar të komunizmit jugosllav me karakter antihistorik kundër shqiptarëve, të cilët janë të njohur më botërisht në shtypin e kohës.

Megjithatë, në këtë rrafsh do të ofrojmë një tablo krahasuese, për nga aspekti i përmbajtjes konceptuale, ndërmjet shtypit të fshehtë të organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë dhe shtypit zyrtar jugosllav.

Subjekti	Shtypi zyrtar jugosllav	Shtypi i fshehtë i organizatave të fshehta me karakter çlirimtar
Qëllimi kryesor	Propagandimi i ideologjisë jugosllave, krijimi i identitetit të përbashkët jugosllav	Mobilizimi i masave të gjera popullore shqiptare, ngritja e ndërgjegjes kombëtare dhe përhapja e ideve çlirimtare
Liria e shprehjes	E kufizuar, kontrolluar, nën censurë strikte	E lirë, pa censurë, e fokusuar në kritikën ndaj regjimit dhe arritjen e qëllimeve atdhetare
Përmbajtja	Lajme të filtruara, artikuj propagandistikë, lavdërim për politikën federale, si dhe udhëheqësit jugosllavë	Artikuj politikë, ideopolitikë, historikë, edukativë; proza, poezi, këngë dhe tekste atdhetare; analiza kritike e shtypit dhe politikave jugosllave
Stili dhe gjuha	Formale, burokratike, shpesh e thatë; përdorim i ideologjisë hibride	Patos patriotik, i fuqishëm dhe mobilizues; gjuhë e thjeshtë, e kuptueshme dhe orientuese për masat
Shpërndarja	Masive, në qindra-mijëra kopje, e legalizuar	Diskrete, fillimisht disa dhjetëra kopje, më vonë deri në 500-1000; shpërndarje dorë më dorë, vetëm tek individë të besuar
Ndikimi	Përforconte status quo-në, mbështeste regjimin dhe censuronte shqetësimet reale të popullit	Rritej ndërgjegjja kombëtare, krijoheshin rrjetë të organizuara, mobilizoheshin brezat e rinj dhe bëheshin thirrje për veprim konkret

⁵³ Mehmet Hajrizi, në shtypin klandestin të Lëvizjes Kombëtare, dorëshkrim i pabotuar.

Ky krahasim tregon qartë se shtypi i fshehtë nuk ishte vetëm një alternativë mediatike, por një armë ideopolitike dhe organizative për të sfiduar regjimin jugosllav dhe për të përgatitur brezat për luftën çlirimtare.

Megjithatë, këto organizata, në pamundësi për të zhvilluar veprimtari politike të hapur, përmes shtypit të fshehtë intensifikonin aktivitetin atdhetar, duke shpjeguar të vërtetat mbi gjendjen e robëruar të popullit shqiptar nën Jugosllavi nga njëra anë, dhe duke inkurajuar masat e gjera popullore për angazhim konkret në luftën për të drejtat historike të tyre nga ana tjetër.

Siç e kemi theksuar më sipër, shtypi i fshehtë me karakter çlirimtar i kishte shtruar vetes detyrën që, përveç afishimeve të veprimtarisë politike, të trajtonte dhe tema të karakterit ideopolitik, ekonomik, historik, kulturor, arsimor dhe edukativ.

Po ashtu, aty botoheshin tema të ndryshme si: prozë, poezi, këngë me karakter atdhetar, artikuj mbi jetën dhe veprimtarinë e heronjve shqiptarë, etj., ku autorë ishin vetë veprimtarët e organizuar të këtyre strukturave⁵⁴. Këto përzgjedhje shkrimesh larushish ishin tërësisht komplementare me ideologjinë e trashëguar të socialdemokracisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, një orientim krejtësisht progresiv në kontekst kohor. Dhe jo rastësisht, në një nga analizat e sektorit analitik të shërbimit sekret jugosllav, thuhej se: “Këto organizata kundërrevolucionare e keqpërdorin ose fshihen pas termeve marksiste-leniniste pasi në të vërtetë ato janë organizata të tipit nacionalist”⁵⁵.

Përkundër kësaj, ky raport, për ata që e njohin këtë fushë, duhet marrë në një trajtim të kujdesshëm, sepse ekspozon të dhëna bruto. Por, është një fakt i pamohueshëm se shërbimi sekret i Jugosllavisë, për llogari të tij, bënte analiza mbi këto organizata të fshehta me karakter çlirimtar, të cilat vepronin për të siguruar të drejta të barabarta për shqiptarët me popujt e tjerë nën Jugosllavi dhe për të drejtën për vetëvendosje.

Pra, thjesht, këtu bëhej fjalë për dy përplasje botëkuptimesh që luftonin me njëra-tjetrën për dekada rresht, pa pushuar. Kjo luftë zhvillohej në vazhdimësi, mes organeve represive shtetërore serbo-jugosllave dhe organizatave të fshehta me karakter çlirimtar dhe anti-jugosllav në Kosovë.

E para kishte të gjitha levat shtetërore; e dyta, në mënyrë tepër të fshehtë zhvillonte luftën e saj mobilizuese dhe agjitative përmes shtypit; e para ndiqte rrugët e reprezaljeve, likuidimeve fizike dhe burgosjeve të veprimtarëve

⁵⁴ ASHAK, Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, Njësia Organike: Penale, Nr. R. 74, Nr. L. 69, viti 1982, “Këngët e lirisë”.

⁵⁵ Arkivi Shtetëror i Sllovenisë, Strogo aupno! Ae: IV/4912, 28.04.1981.

shqiptarë; e dyta ndiqte luftën për ndërgjegjësimin e masave të gjera popullore shqiptare, me qëllim ngritjen e një rezistence anti-jugosllave. Kjo luftë zhvillohej tepër ashpër midis këtyre dy botëkuptimeve, ose, me terma më të butë, midis të kauzës kombëtare shqiptare dhe Federatës Jugosllave. Kështu që, përveç artikujve denoncues kundër Jugosllavisë, me qëndrime të forta nga pikëpamja e dekonstruktimit të doktrinës së saj të Vëllazërim-Bashkimit, një doktrinë e panatyrshme, qoftë nga pikëpamja ideologjike, historike dhe biologjike, veçanërisht në raport me shqiptarët, në kuadër të shtypit të fshehtë anti-jugosllav botoheshin edhe artikuj të qëndrimeve zyrtare të shtetit amë⁵⁶. Kjo ndodhte rëndom, jo si qëllim në vete, për ta implikuar shtetin amë në një kuptim përplasjesh shqiptaro-jugosllave të asaj kohe, por më shumë lidhej me atë që këto organizata, në platformat e tyre, si qëllim suprem kishin bashkimin e tokave shqiptare në një shtet të vetëm- Shqipërinë.

Së dyti, aty trajtoheshin problemet themelore mbi të drejtat historike të popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, veçanërisht e drejta e popujve për vetëvendosje, e cila shqiptarëve jashtë Shqipërisë londineze u ishte mohuar përmes tratativave të ndryshme gjatë Luftës së Dytë Botërore, sidomos në kuadër të Mbledhjes së Dytë Prizrenit, në korrik të vitit 1945, gjatë së cilës ishte bërë revidimi i të gjithë vendimeve të Konferencës së Bujanit⁵⁷.

Natyrisht, tezat e tilla nuk mund të debatoheshin në shtypin e regjimit jugosllav, me pretekstin se ishin irredentiste, nacionaliste dhe thellësisht të dëmshme. Në këtë kontekst, duke ditur se këto tema për shqiptarët ishin tabu, pasi që trajtimi i tyre publik, sipas ligjeve në fuqi të kodit penal të Federatës Jugosllave, dënohej nga 5-15 vjet burg të rëndë, as individë, qofshin ata studiues, as veprimtarë të organizuar, por as masat e gjera popullore nuk kishin mundësi të debatonin në këtë pikëpamje.

Andaj, në kontekst të kësaj, organizatat e fshehta, me theks të veçantë GRK-OMLK, të vetëdijshme për këtë gjë, në çdo numër të gazetës së tyre, pothuajse gjithmonë përfshinin një artikull me përmbajtje të tillë, me qëllim të informimit të drejtë dhe të plotësisht shpirtëror të masave të gjera popullore, të cilat nuk mund të shprehnin mendimet e tyre në shtypin e regjimit jugosllav, e as nuk guxonin të diskutonin në rrethet e gjera publike⁵⁸. Së treti,

⁵⁶ Gazeta "Liria", Organ agjitativ, i Marksistë Leninistëve të Kosovës, tetor, 1980, Nr.1, f, 4; po ashtu, "Liria", dhjetor 1981, Nr. 6, f, 7.

⁵⁷ Alban Dobruna, Konferenca e Bujanit, Gurthemel i shtetësisë së Kosovës 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944, , Instituti i Historisë, Prishtinë, 2023, f, 226.

⁵⁸ Zëri i Kosovës, Nr. 2, Prill 1974, f, 3.

aty botoheshin artikuj që shprehnin afirmimin dhe mbrojtjen e interesave dhe aspiratave të kombit shqiptar në ish-Jugosllavi. Së katërti, shkruhej për një pritshmëri revolucionare, e cila kishte shumë rëndësi për frymën mobilizuese të organizatës. Së pesti, synohej përhapja e frymës së rezistencës në çdo nivel shoqëror. Së gjashti, theksohej papajtueshmëria me armikun, në këtë rast Jugosllavinë. Së shtati, e vërteta e të gjitha këtyre që u përmendën më lart, bazoheshin në literaturë shkencore. Në çdo shkrim apo artikull ofroheshin dëshmi vërtetuese në fusha të ndryshme si në fushën e ekonomisë, shëndetësisë, edukimit dhe kulturës, si dhe në rrafshin e historisë kombëtare.

Një larushi e këtyre shkrimeve, e përgatitur me stil dhe gjuhë të thjeshtë, e bënte përmbajtjen e këtij shtypi të fshehtë të kapshme dhe shumë tërheqëse për gjeneratën e re të asaj kohe, por njëkohësisht edhe për shtresën punëtore dhe fshatarësinë e thjeshtë, si kategori që përfaqësonin shtresat e mesme shoqërore.

Pra, i tërë misioni i këtij shtypi kishte si qëllim të lidhte masat e gjera popullore me frymën e organizatave të fshehta nacionalçlirimtare, t'i edukonte me vlera patriotike dhe revolucionare, t'i mobilizonte dhe, si qëllim final, t'i organizonte në një moment të përshtatshëm për një kryengritje mbarëkombëtare, në shërbim të realizimit të të drejtave të popullit shqiptar nën sundimin e Jugosllavisë.

Rëndësia e shtypit të fshehtë me karakter anti-jugosllav nga perspektiva kohore

Nëse e përcaktojmë drejt rolin, temat e trajtuara dhe qëllimin e këtij shtypi, i cili filloi në vitin 1973, me numrin e parë të gazetës që doli më 1 shkurt 1974 nën drejtimin e organizatës së fshehtë me karakter çlirimtar “Grupi Revolucionar i Kosovës” (GRK-OMLK), me gazetën e saj “Zëri i Kosovës”, më vonë “Pararoja” dhe së fundmi gazeta “Liria”, pa frikë mund të themi se argumentohet teza e Mehmet Hajrizit se “ky shtyp përbënte fillimet e shtypit pa censurë”⁵⁹. Ky tip i shtypit mund të quhet i tillë sepse ishte i organizuar në fshehtësi të thellë, krejtësisht jashtë sistemit shtetëror jugosllav dhe, më e rëndësishmja, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të.

Edhe pse përmes një rruge shumë të gjatë dhe me shumë sakrifica përgjatë jetës së tij, platforma politike dhe porosinë e këtij lloji të shtypit janë

⁵⁹ Mehmet Hjarizi, Recension mbi librin e autores, Rudina Zeqiri, f. 10.

bërë realitet. Kjo arritje lidhet me faktin se organizatat e fshehta me karakter çlirimtar nuk e ndalën punën e tyre dhe as nuk e lanë fjalën pa veprime. Së dyti, ky shtyp gjeti përkrahje të gjerë tek rinia shqiptare, e cila absorbonte frymën revolucionare më shpejt dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Së treti, si i tillë, ky shtyp u bë, ashtu siç shkruhej në artikujt e tij, një tribunë e vepërimtarëve, ku shpreheshin dhe mbroheshin mendimet, dëshirat dhe aspiratat kombëtare⁶⁰.

Sot, shtypi i fshehtë, me shumëllojshmërinë e formave të botimeve periodike, me përmbajtje dhe formë të pasur, si dhe me një organizim të lartë dhe të qëndrueshëm për kohën kur u botua dhe u shpërnda, duke iu përmbajtur destinacionit, synimeve dhe natyrës së lexuesit të tij, ka fituar një fizionomi origjinale.

Ai tashmë ka zënë vendin e nderuar si fillim i shtypit pa censurë kundrejt organeve represive shtetërore jugosllave dhe ka dalë fitimtar në raport me shtypin legal shtetëror të kësaj federate, i cili drejtohej dhe censurohej nga Partia Komuniste e Jugosllavisë.

Përfundime

Shtypi i fshehtë, i organizuar nga GRK-OMLK dhe organizatat e ngjashme me karakter çlirimtar, përfaqëson një formë të veçantë të komunikimit me masat e gjera popullore, i cila zhvillohej në kushte jashtëzakonisht të rënda politike dhe sekrete, për shkak të persekutimit dhe kontrollit të plotë të regjimit jugosllav kundrejt shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të saj jashtë Shqipërisë londineze. Sot ky shtyp vlerësohet për disa karakteristika kyçe:

Artikujt dhe shkrimet e botuara kishin për qëllim jo vetëm informimin, por dhe edukimin dhe mobilizimin e popullit shqiptar në Kosovë dhe vise të tjera nën sundimin jugosllav, duke rritur ndërgjegjen kombëtare dhe frymën revolucionare për luftën çlirimtare.

Përmbajtja e shtypit të fshehtë ishte në përputhje me ideologjinë dhe filozofinë e trashëguar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare, duke e kthyer këtë tip të komunikimit me masat e gjera popullore në një instrument për ruajtjen dhe transmetimin e identitetit kombëtar dhe të drejtave historike të shqiptarëve.

Ky shtyp synonte të kundërshtonte propagandën e mediave zyrtare jugosllave, të demaskonte doktrinën e Vëllazërim-Bashkimit dhe politikën shtypëse

⁶⁰ Gazeta "Liria", tetor, 1980, f. 1.

të regjimit jugosllav, duke ofruar një platformë të lirë mendimi, kritikës dhe reflektimit për masat e gjera popullore.

Artikujt dhe botimet sot përbëjnë një burim të çmuar historik dhe dokumentar, duke ofruar dëshmi të gjalla për veprimtarinë e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar, sakrificën e veprimtarëve dhe luftën për të drejtat e shqiptarëve nën sundimin e Jugosllavisë.

Për më tepër, ky shtyp ishte i organizuar në një fshehtësi të thellë, shpërndaj dorë më dorë dhe kishte një strukturë të qartë redaksionale dhe të përgatitur në rrafshin ideopolitik, duke krijuar një medium të besueshëm dhe me ndikim të drejtpërdrejtë te lexuesi. Ai krijoi një lidhje të drejtpërdrejtë mes veprimtarëve të organizatave të fshehta dhe masave të gjera popullore, duke i frymëzuar për angazhim aktiv në luftën për çlirimin kombëtar dhe për sensibilizimin e të drejtave të mohuara historike të shqiptarëve jashtë Shqipërisë londineze.

Bibliografi:

Burimet arkivore:

- Arkivi i Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme -AMEPJ
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës- ASHAK
- Arkivi i Shoqatës së të Burgosurve Politik të Kosovës
- Arkivi Shtetëror i Sllovenisë

Literatura:

- Mehmet Hjrizi, *“Historia e një Organizate politike dhe Demonstratat e Vitit 198”*, Botime Toena, Tiranë 2008.
- Rudina Zeqiri, *“Format Specifike të Komunikimit të Organizatave të Fsheta shqiptare Gjatë Monizmit Jugosllav”*, Tetovë 2020.
- Mehmet Hajrizi & Gani Sylja, *“Nga Grupi Revolucionar të Fronti i Republikës”*.
- *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, (Memorandume, vendime, protesta, thirrje)*, përgatitur nga Sefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Akademia e Shkencave të RSP të Shqipërisë- Instituti I Historisë, Tiranë 1978.
- Mehmet Hjrizi, *“Mehmet Hajrizi, në shtypin klandestin të Lëvizjes Kombëtare”*, dorëshkrim i pabotuar.
- Alban Dobruna, *“Konferenca e Bujanit, Gurthemel i shtetësisë së Kosovës 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944”*, , Instituti i Historisë, Prishtinë, 2023.

Shtypi:

- Gazeta, Rilindja.
- Gazeta “Zëri i Kosovës” Nr. I, datë 1. Shkurt 1974.
- Pararoja- 1979.
- Gazeta , “Zëri i Kosovës”, Nr.2. Prill, 1974.
- Gazeta “Liria”.

Intervista dhe konsultime:

- Intervistë me Mehmet Hajrizin, viti 2019.
- Konsultim me veprimtarin dhe studiuesin Bardhyl Mahmutin dhe Ramadan Avdiu.

Fatmir ARIFI

The Institute of History "Ali Hadri"

Email: fatmir.arifi@live.com

ORCID: 0009-0004-2754-6035

KUD: 070(496.51)"1970/1981"(05)

&

Dorina DAIU

The Institute for the Study of Communist

Crimes and Consequences in Albania

Email: dorina.daiu@iskk.gov.al

ORCID: 0009-0009-2724-3938

KUD: 070(496.51)"1970/1981"(05)

SUMMARY**THE UNDERGROUND PRESS - NEWSPAPERS AS
INSTRUMENTS OF COMMUNICATION AND RESISTANCE
BY LIBERATION-ORIENTED SECRET ORGANIZATIONS
IN KOSOVO DURING 1970 - 1981**

The underground press, organized by GRK-OMLK and similar liberation-oriented organizations, represents a distinct form of communication with the broader popular masses, developed under extremely difficult political and clandestine conditions due to persecution and the full control exercised by the Yugoslav regime over Albanians in Kosovo and its territories outside "London-based Albania." Today, this press is valued for several key characteristics: The articles and writings it published aimed not only to inform but also to educate and mobilize the Albanian population in Kosovo and other areas under Yugoslav rule, fostering national consciousness and revolutionary spirit for the liberation struggle.

The content of the underground press aligned with the ideology and philosophy inherited from the Albanian National Awakening, transforming this form of communication with the broader masses into an instrument for preserving and transmitting national identity and the historical rights of the Albanian people. This press sought to counter the propaganda of official Yugoslav

media, to expose the doctrine of “Brotherhood and Unity” and the repressive policies of the Yugoslav regime, while providing a platform for free thought, critique, and reflection for the general public.

Its articles and publications now constitute a valuable historical and documentary source, offering vivid evidence of the activities of clandestine liberation-oriented organizations, the sacrifices of their members, and the struggle for the rights of Albanians under Yugoslav rule.

Moreover, this press was organized with deep secrecy, distributed hand to hand, and maintained a clear editorial structure and ideological-political preparation, creating a credible medium with a direct impact on its readers. It established a direct connection between the activists of underground organizations and the broader masses, inspiring active engagement in the struggle for national liberation and raising awareness of the historically denied rights of Albanians outside “London-based Albania.”